



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME Nr. 2 E PUNËTORËVE TË QYTETIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 23/07/2018

Nga: Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit, Tiranë.

Drejtuar: Bashkimi i operatorëve ekonomik “RSM Company” shpk me NUIS L04803001U me adresë: Rruga Xhorxhi Martini, Nr. 20, Godine Nr. 11 - kateshe, Shkalla 2, Kati 7, Tiranë & “ALS Engineering Construction” shpk me NUIS L71410038G me adresë: Rruga "Abdyl Frasheri", Pallati jeshil prane Vesa Center, kati 8, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Procedurë e Hapur.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-74749-06-13-2018.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Sinjalistikë për korsitë biçikletash” afati: 45 (dyzetë e pesë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☒ oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 24, Date 18.06.2018.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Shoqëria “R. S. & M” shpk me NUIS K32203002I dhe me vlerë 54.371.500 (pesëdhjetë e katër milion e treqind e shtatëdhjetë e një mijë e pesëqind) leke pa TVSH.
2. Bashkimi i operatorëve ekonomik “RSM Company” shpk me NUIS L04803001U & “ALS Engineering Construction” shpk me NUIS L71410038G dhe me vlerë 54.533.400 (pesëdhjetë e katër milion e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind) leke pa TVSH.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “R. S. & M” shpk me NUIS K32203002I
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
 - a) Operatori ekonomik nuk plotëson piken 2.3.1 Kapaciteti Teknik: “Furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, të aktivitetit të operatorit, në vlerën prej jo më pak se 40% e fondit limit të vënë

në dispozicion përkatësisht **21.818.000** (njëzetë e një milion e tetëqind e tetëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

Këto furnizime të ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar detyrimisht me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate dhe faturat me tvsh.

OSE

- b. Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur fatura tatimore shitje, ku shenohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”pasi kontratat e paraqitura nga O.E janë jashtë afateve ligjore.
- b) Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.3.2 Kapaciteti Teknik: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi / distributori i autorizuar për mallin objekt prokurimi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij” pasi O.E nuk ka paraqitur asnjë dokument për permushjen e kësaj pike.
- c) Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.3.5 Kapaciteti Teknik: “Në rast se Operatori ekonomik nuk është prodhues ai duhet të paraqesë Çertifikatën sipas standarteve **ISO 9001-2008 (e vlefshme)** të prodhuesit të mallrave objekt prokurimi.” pasi O.E nuk ka paraqitur asnjë dokument për permushjen e kësaj pike.
- d) Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.3.6 Kapaciteti Teknik: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë për artikujt objekt prokurimi, katalogun/skedat teknike, ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.” pasi O.E nuk ka paraqitur asnjë dokument për permushjen e kësaj pike.
- e) Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.3.7 Kapaciteti Teknik: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë në vendin dhe orën e përcaktuar për hapjen e ofertave në dokumentat e tenderit, mostra të të gjithë mallrave, objekt prokurimi. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim”pasi O.E nuk u paraqit ne oren dhe vendin e percaktuar ne D.S.T.
- f) Operatori ekonomik nuk ploteson piken 2.3.8 Kapaciteti Teknik: “Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.Kamion me kapacitet mbajtes minimum 10 ton ne pronesi ose qera”pasi mjeti I paraqitur nga O.E ka nje kapacitet mbajtes nga 3.5 - 7.5 ton.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqërinë **Bashkimi i operatorëve ekonomik “RSM Company” shpk me NUIS L04803001U** me adresë: Rruga Xhorxhi Martini, Nr. 20, Godine Nr. 11 - kateshe, Shkalla 2, Kati 7, Tiranë & **“ALS Engineering Construction” shpk me NUIS L71410038G** me adresë: Rruga "Abdyl Frasheri", Pallati jeshil prane Vesa Center, kati 8, Tiranë, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej: **54.533.400** (pesëdhjetë e katër milion e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e katërqind) lekë pa TVSH, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit, Rruga 5 Maji**, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 (tridhjeë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 13.07.2018.

Ankesa: Nuk ka.

